



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 730/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Skender Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Skender Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë dega në Lipjan, me shenjën ZL.Anr.730/2017, ZL.Anr.731/2017 dhe ZL.Anr.732 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.730/2017 dhe ZL.Anr.731/2017 dhe ZL.732/2017 me datën 09.11.2017, nga parashtruesi i ankesave Skender Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA, në të cilat thekson se ka pasur vjedhje të votave në këto Qendra të Votimit: 1325E, 1312E dhe 1317E. Më tej kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen votat në vendvotimet e cekura në ankesë.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur formularin e votave të kandidatëve.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.730/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të tri ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankesat janë të pabazuara sepse nuk është specifikuar Vendvotimi i saktë në Qendra të Votimit ku ka ndodhur parregullsitë, dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë. Prandaj Paneli ankesat e ankuesit i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat e ankuesit i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.730/2017 më datën 10.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*